

NJERIU DHE NATYRA

1 orë në javë, 36 orë në vit

HYRJE

Lënda **Njeriu dhe natyra** fillon të mësohet në klasën e 3 (tretë), si lëndë e integruar e shkencave të: biologjisë, kimisë, fizikës, dhe gjeografisë. Nxënësit njihen me natyrën që na rrethon, të mirat materiale për jetë, trupat, pozitën dhe rolin e njeriut në mesin e tyre, nevojat e vazhdueshme të njeriut për burime të reja të energjisë dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

QËLLIMET

Programi i lëndës **Njeriu dhe natyra** në klasën e tretë ka për qëllim:

- të zhvillojë aftësi të nxënësit për të njohur natyrën, objektet e saj, mjedisin jetësor dhe ruajtjen e tij.
- të kultivojë nxënësi shprehi dhe të fitojë shkathtësi për vrojtime, matje, arritje në përfundime të sakta të ligjshmërive natyrore, ndërlihdje të tyre dhe punë të pavarur në zgjidhjen e problemeve konkrete;
- të formohet nxënësi personalitet stabil dhe vetëkritik, i qëndrueshëm dhe i gatshëm për bashkëpunim me mësimdhënës në shkollë dhe jashtë saj dhe i aftë në ballafaqim me sfidat e jetës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

- trupat, përmasat dhe pozitën e tyre;

- përbërjen e trupave (lëndët e pastra dhe të përziera) dhe shndërrimet e tyre;
- vetitë, lëvizjet e trupave (lëndëve, objekteve);
- proceset jetësore, ndërtimin dhe marrëdhëniet e qenieve të gjalla me mjedisin.

Të kuptojë:

- bashkëveprimin mes trupave (mekanikë dhe magnetikë);
- ndërveprimin e qenieve të gjalla dhe të mjedisit;
- ditë-natën dhe stinët e vitit si rrjedhojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit dhe rreth Diellit;
- rolin e ushqimit dhe të higjienës në shëndetin e njeriut;
- shndërrimet e lëndës dhe të energjisë.

Të zbatojë:

- përdorimin e lëndëve ushqyese, higjienike dhe shëndetësore në jetën e përditshme;
- termometrin për matje të temperaturës;
- ilustrime, harta dhe fotografi;
- njohuritë e fituara për ruajtjen e mjedisit jetësor.

Të analizojë:

- përbërjen e lëndëve të ndryshme;
- burimet e energjisë.

Të sintetizojë:

- të kombinojë dy e më shumë lëndë për të përftuar lëndë të reja e me veti të ndryshme.

Të vlerësojë:

- rëndësinë e natyrës në jetën dhe në veprimtarinë e njeriut;
- rolin e njeriut në ruajtjen e mjedisit jetësor.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE
1 orë në javë, 18 javë në vit

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve	%
I. Qeniet e gjalla dhe proceset jetësore	1. Karakteristikat e qenieve të gjalla. 2. Bimët dhe kafshët 3. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	7	38.88
II. Lënda dhe energjia	1. Lënda dhe vetitë e saj 2. Shndërrimet e lëndës	4	22.28
III. Proceset fizike	1. Forca dhe lëvizja 2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita	4	22.28
IV. Toka dhe gjithësia	1. Toka, Dielli, Hëna dhe planetët	3	16.66
Tërësisht		18	100

	<p>I.3. Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gjatë jetës së tyre njeriu, bimët dhe shtazët pësojnë ndryshime të rregullta në formë të ciklit jetësor. • Në pyll jetojnë së bashku lloje të ndryshme të bimëve dhe shtazëve të varura mes vete dhe nga kushtet fizike të pyllit. • Njeriu sëmundet nga sëmundje të ndryshme, shkaktarë të të cilave janë gjallesat shumë të imëta të cilat nuk shihen me sy-mikrobet. 	<p>dhe të flutures.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë dhe të përshkruajë ndryshimet në bimë prej lules deri në frut. - Të dallojë komponentet e gjalla dhe jo të gjalla të një mjedisi jetësor, siç është pylli. - Të emërtojë bimët dhe shtazët karakteristike të pyllit. - Të përshkruajë se bimët në pyll prodhojnë ushqimin për vete dhe për të gjithë organizmat e tjerë, se disa shtazë ushqehen vetëm me bimë, të tjerat vetëm me shtazë, kurse disa të tjera edhe me bimë edhe me shtazë - Të përshkruajë se sëmundjet e ndryshme të njeriut shkaktohen nga gjallesat e imëta të cilat nuk shihen me sy (mikrobe) dhe se këto barten përmes njerzëve, shtazëve, ujit dhe ushqimit të papastër. - Të tregojë se disa sëmundje ngjithëse fitohen vetëm një herë gjatë jetës, kurse parandalimi i tyre bëhet përmes vaksinimit. 	
--	--	---	---	--

<p>II. Lënda dhe energjia</p>	<p>II.1 Lënda dhe vetitë e saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lënda, klasifikimi dhe toka si burim i të mirave materiale për jetë (Lëndët ose artikujt e përditshëm me të cilët jeton dhe punon nxënësi, toka burim i të gjitha të mirave materiale jetësore) • Uji dhe ajri (Përhapja në natyrë vetitë dhe përdorimi i ujit dhe i ajrit, funksioni i tyre për jetë) 	<p><i>Nxënësi do të jetë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet lëndëve, me anë të shqisave. - Të emërtojë llojet e ndryshme të lëndëve, siç janë: uji, qelqi, druri, metali, plastmasat, letra, sheqeri, vaji etj. - Të tregojë lëndët që nxirren nga toka, siç janë: ushqimet, lëndët e djegshme, mineralet, druri, shkëmbinjtë, uji etj., që përdoren në jetën e përditshme. - Të përshkruajë ujin si lëndë e domosdoshme në natyrë, në teknologji dhe në jetë - Të shpjegojë vetitë e ujit, qarkullimin në natyrë (avullimi, kondensimi, ngrirja, të reshurat), - Të përcaktojë temperaturën e lëndëve të ndryshme me termometër. - Të vlerësojë rolin dhe qëndrimin e njeriut për ruajtjen e ujit dhe të mjedisit nga ndotësit. - Të përshkruajë ajrin si lëndë e gaztë që na rrethon dhe që nuk e shohim, por në forma të ndryshme 	<p>Punëdore (punimi i modeleve nga letra dhe kartoni, lëndët ushqyese, rreziqet nga lëndë të ndryshme, zjarri, rryma elektrike, ndotja e ambientit etj.). Arti figurativ (dallimi ngjyrave, modeleve i etj.) Mjekësia dhe shëndetësia (mirëmbajtja e higjienës personale, mënyra e përdorimit, e ruajtjes, afati i skadencës së barnave etj.).</p>
--------------------------------------	---	---	---	--

			<p>e hetojmë praninë e tij (procesi i frymarrjes, procesi i djegies, kundërmimi, lëvizja e erës etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësojë rëndësinë e ajrit për jetë (procesin e frymarrjes, procesin e djegies, procesin e zhvillimit të bimëve dhe në industri). 	
II. Lënda dhe energjia	II. 2. Shndërrimet e lëndëve	<ul style="list-style-type: none"> • Lëndët ushqyese, higjienike dhe burimet e energjisë (Lëndët ose artikujt e përditshëm ushqimorë dhe higjienikë, burimet kryesore të energjisë dhe përdorimi i tyre) 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë lëndët kryesore të ushqimit (buka, drithërat, mishi, peshku, prodhimet e qumështit, sheqeri, mjalti, gjalpa, vaji, pemët, perimet vitaminat dhe kripa e gjellës). - Të dallojë lëndët ushqyese me prejardhje bimore dhe shtazore. - Të identifikojë lëndët ushqimore natyrore dhe ato të përpunuara (artificiale). - Të arsyetojë rëndësinë e lëndëve higjienike për ruajtjen e shëndetit. - Të vlerësojë ndikimin e dëmshëm të lëndëve helmuese (acidet, mjetet për zbardhje dhe dezinfektim “varikinet”, detergjentet, pesticidet), të djegshme (alkoolet, nafta, benzina, gazi propan- butan) dhe pëlcitëse (fishekzjarret) . 	

			<ul style="list-style-type: none"> - Të shfrytëzojnë recetat për përdorimin e lëndëve higjienike, të cilat janë të shënuara në paketim të tyre. - Të përshkruajnë burimet kryesore të energjisë, duke filluar nga ushqimi (për organizëm), diellore, lëndët e djegshme, qymyri, nafta, gazi natyror, druri, uji, era, etj., dhe rëndësia e tyre për jetë, - Të përgatisin çaj, kafe, pije freskuese, akullore etj. 	
III. Proceset fizike	III.1. Forca dhe lëvizja	<ul style="list-style-type: none"> • Trupat në natyrë dallohen sipas vetive të ndryshme (ngjyrë, formë, peshë, madhësi, temperaturë dhe përbërje). • Trupat vendosen në baraspeshim në mënyra të ndryshme (kandari, peshorja, luhatja në traverzë). • Makinat e thjeshta shërbejnë për të kryer pune më lehtë. 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë trupat sipas ngjyrës, formës, përbërjes (të ngurtë, të lëngët, të gaztë, elastik), sipas peshës, madhësisë (vëllimi) dhe temperaturës. - Të tregojë shembuj të baraspeshimit të trupave, duke u bazuar në lojërat e përditshme në shkollë dhe në shtëpi. - Të identifikojë gjashtë lloje të makinave të thjeshta: llozin, vidën, çikrikun, rrotën dhe boshtin, rrafshin e pjerrët dhe pykën dhe të gjejë shembuj të makinave të thjeshta që mund t'i gjejë në shkollë dhe në shtëpi. 	<p>Arti figurativ për vizatime të ndryshme, vizatimin e makinave të thjeshta dhe për njohjen e ngjyrave.</p> <p>Punëdore për njohje të formës, madhësisë, peshës dhe vëllimit të trupave, për demonstrimin e baraspeshimit të trupave dhe ndërtimin e makinave të thjeshta.</p>

III. Proceset fizike	III.2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita	<ul style="list-style-type: none"> • Magnetët veprojnë në mes veti me pole të veta pa u takuar fare. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrojë tërheqjen dhe shtyrjen e poleve të njëjta magnetike pa u takuar fare dhe të gjejë shembuj të bashkëveprimit dhe të zbatimit të magnetëve në jetën e përditshme. 	Punëdore, për ndërtimin e mbajtëseve në të cilat duhet të varen magnetët me fije najloni me qëllim të demonstrimit të veprimit në mes tyre.
IV. Toka dhe hapësira	IV.1 Rrethina ime	<ul style="list-style-type: none"> • Orientimi në natyrë (skica, harta, globi) 	<ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë anët kryesore të botës (veri, jug, lindje dhe perëndim) - Të tregojë se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe tërë Toka mund të paraqitën në letër, glob të zvogluara dhe me shenja të veçanta 	
IV. Toka dhe hapësira	IV.2. Toka, sistemi diellor dhe gjithësia	<ul style="list-style-type: none"> • Dita, nata dhe stinët e vitit • Kosova – Vendi im 	<ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë se Dielli është burim i dritës, i nxehtësisë dhe i jetës në Tokë,. - Të përshkruajë arsyet e ndërrimeve të ditë-natës, stinëve të vitit dhe ndryshimet e motit. - Të tregojë pozitën e Kosovës në hartë dhe fqinjët e saj. - Të përshkruajë veçoritë elementare natyrore (relievin, ujin, ndryshimet e motit, botën bimore dhe shtazore) në Kosovë. 	

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të lëndës Njeriu dhe natyra, është e domosdoshme të zbatohen metoda , teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, peizazhe, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë kuzhine, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore – kompjuter, internet etj.).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera participojnë në tërësinë e formimit të personalitetit për t'u përballur me sfidat jetësore..

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjutër);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale, në veçanti përmes kompjuterit;

- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat e objekteve industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatese didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të matur punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi, stafi arsimor, shkolla dhe komuniteti i saj. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto forma të vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo temë mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe të punimeve me shkrim etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione për përparimin e nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësues;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojë përparimin e nxënësve
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojë për përmirësimin e mësimit bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimit dhe mësuesia e planit dhe e programit të njeriut dhe të natyrës, mësimit dhe nxënësit duhet të shfrytëzohen burime dhe mjete të ndryshme të informimit:

- 1) Literaturë për lëndën Njeriu dhe natyra në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja botërore.
- 2) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 3) Fotografji, atlase, modele, skema, diagrame, makete, harta, glob etj.
- 4) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 5) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 6) Literaturë tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjete të tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjete ndihmëse mësuese, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësuesisë.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësuese duhet t'i takojë edhe nxënësit.